

Është bërë e zakonshme që kundërshtarët e mi ta citojnë emrin tim, siç citonin dikur Biblën dhe Kuranin etërit e tyre ateistë. Megjithatë, përpara qytetarëve ndihem i detyruar të bëj sqarime si vijon: Së pari, për deklaratat e përsëritura të Edvin Ramës, se unë kam thënë që inceneratorët janë përparësi, unë këtë deklaratë e kam bërë, e bëj dhe do ta bëj. Në renditjen që Bashkimi Europian u bën metodave të pastrimit të plehrave, dikur ka qenë landfilli, para inceneratorëve, ndërsa sot është inceneratori, para landfillëve, por metoda më e rekomanduar sot është riciklimi i plehrave. Duke pohuar këtë as Bashkimi Europian, as unë nuk kam pasur dhe as kam ndër mend që plehrat të bëhen miniera floriri për mafien, të shndërrohen në burime fatkeqësie dhe mafie në vende të ndryshme. Keni përdorur disa herë dhe përdorni këtu shifrën 420 milionë. Në këtë rast dua t'i sqaroj shqiptarët se kjo si aferë ka mundësi të jetë vetëm në Tiranë 420 milionë dhe në tërësi të shkojë më shumë, sepse ju keni dhënë një koncesion për 30 vjet dhe të paguani nga taksat e qytetarëve shqiptarë 29 euro për ton. Zotërinj, u ndërtuan disa landfille gjatë viteve 2005-2013. Fatmirësisht u ndërtuan në Bushat, në Korçë, në Sarandë e tjerë. Cili ka qenë çmimi i vendosur me Bankën Botërore dhe (nëse nuk gaboj) me GTZ-në e Gjermanisë? Çmimi ka qenë 10 euro për ton, kurse ju e jepni me 29 euro për ton. Ju atë që duhet t'u lejojnë ta shesin qytetarët, dheun, i detyroni ta depozitojnë në Sharrë. Por dheu është më vlerë. Është e vërtetë që krijon diku një gropë, por ka një vend tjetër për mbushje, ka një vend tjetër për shtrim. Dheu është pronë, është mall i atyre që e nxjerrin. Ju i detyroni që edhe dheun t'ia shesin kompanisë suaj në Sharrë.

Pra, problemi është se ju i përdorët inceneratorët dhe Sharrën si minierë floriri. Sharra ishte një ndërmarrje publike, por ju sollët Miglioranzi-n. Miglioranzi u cilësuar botërisht si shefi i Ndrangheta-ës në Veneto. A është kështu, apo jo? Marrëveshja mes Miglioranzi-t dhe bashkisë, nëse nuk gabohem, Agolli, ka qenë kryetari i eko-Tiranës, ashtu quhej ndërmarrja. Çfarë ndodh? Brenda një nate Miglioranzi ikën dhe Bashkia e Tiranës ia shet koncesionin e Sharrës Zotos. Po kush është Zoto? Zoto është hajduti i dobishëm që përdoret për të kryer të gjithë skemën e vjedhjeve. Atëherë, përse i ngatërroni gjërat ju? Meqenëse jam këtu, se do të dal te dy djegës të tjerë, që betoheshin se për djegësin e Tiranës nuk po jepnin asnjë lek, po ju them se nuk ka mashtrim më të madh. Për djegësin e Tiranës nga buxheti i shtetit ose buxheti i Bashkisë së Tiranës, pra nga taksat e shqiptarëve, po jepen 29 euro për ton. Duke mbledhur këto qindra e mijëra tonelata, ai po mbledh paratë për të ndërtuar djegësin. Si mund të thoni ju që ky nuk është financim? Ju trefishuat çmimin, nga 10, që është në Bushat me Bankën Botërore, e kaluat në 29 euro, dhe e dhatë për 30 vjet. Imagjinojeni ju se sa arrin kjo! Kjo nuk arrin 400, por ju garantoj që arrin 600 dhe 700, po të merrni shifrën mbi 10 apo 20 euro për ton më shumë, por ka edhe gjëra të tjera shumë të rënda. Inertët, që Mali i Zi i depoziton me 5 euro, në disa vende të caktuara, ju i detyroni të dërgohen aty me 30-40 euro.

Pra, keni krijuar një skemë për të vjedhur çdo qytetar dhe betoheni që nuk po vidhni. Çfarë do të thotë kjo kur thoni nuk kemi vjedhur 400, por 100 milionë? Jo, morë zotëri, edhe për ata 100 milionë, pse themi ka vjedhje? Sepse ju, në kundërshtim me çdo ligj, procedurë të vendit, firmosët kontratën për djegësin e Elbasanit. Për djegësin e Elbasanit dhatë 22 milionë euro, por kushtoi 12 milionë me çelësa në dorë. Ku shkuan 10 milionë? Nuk mund t'ia jepnit Bashkisë së Elbasanit të bënte tenderin dhe ata 10 milionë i mbeteshin buxhetit të shtetit? I ndanë ministrat, i ndanë ministrat. Meqenëse oreksi vjen duke ngrënë, shkojmë tek i Fierit. Për inceneratorin e Fierit duheshin 30 milionë, por me çelësa në

dorë kushtoi 15 milionë. A nuk mund t'i jepej Bashkisë së Fierit të bënte tenderin dhe ata 15 milionë të mbeteshin në buxhetin e shtetit?! Pra, të mos bëjmë kështu. Se thonë që kanë vjedhur, kanë vjedhur dhe kush vodhi?! Po ju vodhët, more zotëri. Si nuk vodhët? Si qenka kjo punë?! Behet komisioni, jo komisioni nuk i shkon në rrënjë problemit. Nxori, por nuk u thirr Artur Metani, zotërinj. Pse nuk u thirr Metani? A e dini ju që ai ka qenë kryetari i Departamentit Ligjor në Kryeministri? Aty duhej të ishte Metani dhe "don Agaço", i cili thoshte në komision "nuk mbaj mend". Çdo njeri, që e njih qeverinë, e di që sekretari i Përgjithshëm është autoriteti i vetëm që kalon, që shqyrton, që harton bashkë me sektorin juridik çdo akt ligjor dhe nënligjor të qeverisë. Metani nuk u thirr, kurse Agaçi bëri si bëri. Nuk shkuat te rrënjët, megjithatë Edi Rama pranoi botërisht, në përgjigje të pyetjes së zotit Belind Këlliçi, se ka shkelur procedurën. Shkelja e procedurës është shkelje ligji, është korrupsion, është e dënueshme në çdo ligj të botës.